



# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE  
NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

MAJ, VITIT MËSIMOR 2015/2016

## UDHËZIM

Koha për zgjidhjen e testit është **70 minuta**.

Mos e hapni testin dhe mos filloni t'i zgjidhni detyrat derisa të mos ju japë leje mësimdhënësi kujdestar.

Testi **DUHET** të jetë i shkruar me laps kimik ose me stilolaps.

Shkruani lexueshëm me shkronja dore.

Nëse shkruani me shkronja shtypi, theksojeni shkronjën e madhe aty ku duhet të jetë. Respekto rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Nëse mendon se ke gabuar me rastin e zgjidhjes së detyrës, vendos një vijë të kryqëzuar (X) mbi të dhe zgjidhe përsëri.

**Nuk guxon të përdorësh korrektorin.**

Detyrat nuk e ke për detyrë t'i zgjidhësh me rend ashtu siç janë dhënë në test.

Nëse e përfundon punën më parë, kontrolloji edhe një herë zgjidhjet tua.

**Detyra do të vlerësohet me zero (0) pikë nëse:**

- është e pasaktë
- është e palexueshme dhe nuk është shkruar qartë përgjigjja
- është e shkruar me laps të thjeshtë
- është shkruar ose qarkuar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë

**ME FAT!**

**SHIFRA E NXËNËSIT**



# FAQJA E ZBRAZËT

Lexoje tekstin dhe anën e pasme të biletës për ndeshjen e futbollit pastaj zhvilloji detyrat 1, 2, 3 dhe 4.

## FIGURA A



## FIGURA B



**1.** Në cilin vend zhvillohet ndeshja e futbollit në mes të Malit të Zi dhe Sllovenisë?

---

1 pikë	
--------	--

**2.** Në anën e pasme të biletës gjendet skica e stadiumit. Përse janë shënuar në skicë anët e botës?

---

---

1 pikë	
--------	--

**3.** Në cilën hyrje do të hyjnë gazetarët në stadium?

1. hyrjen zyrtare
2. hyrjen VIP dhe PRESS
3. hyrjen D E F

*Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.*

1 pikë	
--------	--

**4.** Duke shfrytëzuar të dhënat nga FIGURA A rrethoje në FIGURËN B hyrjen në të cilën do të duhej të hyj pronari/pronarja i/e biletës.

1 pikë	
--------	--

## Lexoje me kujdes tekstin pastaj zhvillo detyrat 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.

### UDHËTIMI NGA PERONI NËNTË DHE TRI TË KATËRTAT

- Të nesërmen Harry u zgjua në orën pesë... dhe pastaj filloi të shëtisë nëpër dhomë duke pritur që tezza dhe i shoqi i saj të zgjohen. (...) Arritën në Kings Kros në orën dhjetë e tridhjetë. Bashkëshorti i tezes Vernon vendosi valixhen e Harryt në karrocë dhe e shtyri atë deri në stacion në vend të tij. Harry mendonte se kjo ishte një gjë jashtëzakonisht e sjellshme nga i shoqi i tezes Vernon, gjithnjë derisa i shoqi i tezes nuk u ndal, duke shikuar peronet me një të qeshur me dashaligësi.

  - Pra, ja ku jemi, djali im. Peroni numër nëntë – peroni dhjetë. Peroni yt duhet të jetë këtu diku në mes, por duket se nuk e kanë ndërtuar ende, apo jo? Të dëshiroj sukses në gjysmën e vjetorit – i tha i shoqi i tezes Vernon me një buzëqeshje edhe më dashakeqe. Dhe iku pa asnjë fjalë.
  - E ndaloi rojën, por nuk pati guxim ta pyeste për peronin nëntë dhe tri të katërtat, po vetëm për trenin i cili niset në orën njëmbëdhjetë. Roja i tha se në atë kohë nuk ka asnjë. (...) Në atë moment një grup njerëzish kaloi pranë tij dhe ai i kapi disa fjalë nga biseda e tyre. Derisa zemra i rrihte si një çekan, Harry e shtyri karrocën e vet, duke ecur mbrapa tyre. Kur u ndalën, ndali edhe ai, mjaft afër që të dëgjonte çfarë flisnin.
- Cili peron është ky? – pyeti një grua trashaluge, nëna e katër djemve flokëkuq.
  - Nëntë e tri të katërtat – bërtiti vajza e vogël, gjithashtu me flokë të kuqërremtë, e cila mbahej për dorën e gruas. (...)
  - Më falni – i tha Harry gruas trashaluge.
  - Përrshëndetje, shpirt – i tha ajo. – Je për herë të parë në Hogvorts? Edhe Roni është i ri, gjithashtu. Duke treguar në djalin e vogël i cili ishte shtatëdhjetë dhe hollak, që kishte pikla në fytyrë, shuplakat dhe shputat e mëdha, dhe hundën e gjatë.
  - Po – u përgjigj Harry. Problemi është – problemi është që nuk e di si...
  - Si të vish deri te peroni? – tha ajo me një mirësi, dhe Harry tundi kokën.
  - Mos u shqetëso – i tha. – Vetëm ec përpara drejtë deri te muri ndarës në mes të peronit të nëntë dhe të dhjetë. Mos u ndal dhe mos u frikëso nëse do të ndeshesh me të, ajo është shumë e rëndësishme. Më së miri është që këtë ta bësh me vrap, nëse je nervoz. Shko tani, shko para Ronit.
- Harry e shpejtoi hapin. Duke u vërsulur drejtë në atë mur ndarës ky do të jetë një problem – duke u mbështetur në karrocë, ai ia dha vrapit... I mbylli sytë dhe ishte i gatshëm të ndeshesh...

Nuk ndodhi gjë... ai vazhdoi të vraponte... më në fund, i hapi sytë.

Lokomotiva me avull e purpurt e kuqe qëndronte pranë peronit të mbushur me njerëz. Në te ishte tabela me mbishkrimin Hogvorts ekspres, ora 11. Harry shikoi pas vetes dhe pa një kalim qemer çeliku me automat për bileta dhe mbishkrimin Platforma nëntë dhe tri të katërtat. Ia arriti qëllimit.

*(fragment nga vepra Harry Potter dhe guri i urtisë, Xhoan K. Rowling)*

#### 5. A) Në tekst është paraqitur:

1. një ngjarje e vërtetë
2. një ngjarje jo e vërtetë

*Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.*

#### B) Shpjegoje përgjigjen.

---

---

1 pikë	
--------	--

#### 6. Caktoje vendin e ngjarjes në tekst.

---

1 pikë	
--------	--

**7. A) Kush e ndihmoi Harryn?**

1. i shoqi i tezes Vernon
2. gruaja trashaluqe
3. roja në peron

*Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.*

1 pikë

**B) Në çfarë provohet ajo ndihmë?**

---

---

1 pikë

**8. Fjalja përmbyllëse e fragmentit është: *la arriti qëllimit*. Shpjegoje çfarë arriti të bëjë Harry.**

---

---

1 pikë

**9. Lexoji me kujdes fjalitë pastaj rrethoje numrin para motivit statik.**

1. Të nesërmen Harry u zgjua në orën pesë, dhe pastaj filloi të shëtiste nëpër dhomë duke e pritur që tezja dhe i shoqi i saj të zgjohen.
2. I shoqi i tezes Vernon vendosi valixhen e Harryt në karrocë dhe e shtyri atë deri në stacion në vend të tij.
3. Duke u vërsulur drejtë në atë zdatk edhe ky do të jetë një problem – duke u mbështetur në karrocë, ai ia dha vrapit...
4. Lokomotiva me avull e purpurt e kuqe qëndronte pranë peronit të mbushur me njerëz.

1 pikë

**10. A) Cila figurë stilistike është përdorur në fjalinë: *Derisa zemra i rrihte si një çekan, Harry e shtyri karrocën e vet, duke ecur mbrapa tyre?***

---

---

1 pikë

**B) Sqaroje domethënien e fjalës qemer, nga fjalja e parafundit në tekst.**

---

---

1 pikë

Lexoje tekstin dhe një pjesë të bisedës në mes të dy shoqeve të cilat kanë lexuar romane për Harry Potterin pastaj zhvilloje detyrën 11.

11.

*Në skenën që lufton kundra dragoit (i cili, në të vërtetë, është i bërë me kompjuter) Harryn e hellin shumë poshtë e lart. Ashtu edhe Dallëndyshja. Aktori mbahej për litarit derisa e ngjiten në një lartësi prej 15 metrash - dhe atëherë e lanë të bien. „Kam qenë i kapur për telit, por asnjëherë nuk jam frikësuar“, thotë ai.*



BASHKËBISEDUESJA 1

Teksti është pjesë e reportazhit nga incizimi i filmit për Harry Potterin.

Teksti është pjesë e analizës letrare të një romani për Harry Potterin.



BASHKËBISEDUESJA 2

Kush ka të drejtë, bashkëbiseduesja 1 apo bashkëbiseduesja 2? Shpjegoje përgjigjen.

---

---

---

---

1 pikë



12. A) Emri i nënvizuar në fjalinë: M'i ka përshkruar malet tona para se të njihesha me to, është në rasën:

1. emërore
2. gjinore
3. dhanore
4. kallëzore

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

B) Cilës pjesë të ligjëratës u përkasin fjalët e nënvizuara në fjalinë e mëposhtme?

Shkruaja pastaj dhe ulesha pranë plakut e rrija me orë të tëra pa lëvizur.

pastaj \_\_\_\_\_

pranë \_\_\_\_\_

2 pikë

13. A) Nga parashtesa dhe folja formo dy folje të reja:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

2 pikë

B) Shkruaji me shkronja numrat:

17 \_\_\_\_\_

600 \_\_\_\_\_

2 pikë

14. Në cilat pesë pyetje duhet të përgjigjet një lajm?

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

1 pikë

**15.** Pranë fragmentit nga vepra letrare shkruaje titullin e veprës dhe emrin e mbiemrin e autorit të saj.

1. *Atje lint diell' i qeshur edhe hëna e gëzuar,  
Fat' i bardh' e mirësija në atë vënt janë mbuluar;  
Nat'atje'është t'jatrë natë edhe dita t'jatër ditë,  
Në pyjet' e gjelbëruar, atje rrinë perënditë.*

\_\_\_\_\_

2. – *Santiago, - i tha djali, kur ata po ngjiteshin nga bregu ku kishin lidhur barkën.  
– Mund të vij prapë me ty në det. Ne tani kemi fituar disa para. Plaku e kish mësuar  
djalin të zinte peshq dhe djali e donte atë.*

\_\_\_\_\_

3. *E nalt n'qiell ma e bukur hana  
Rrezet t'paqta shkon tui shkrië;  
Maje bjeshkve fillon Zana  
N'valle shoqeve m'u prië*

\_\_\_\_\_

3 pikë	
--------	--

**Lexoji vargjet pastaj zhvillo detyrat 16, 17, 18 dhe 19.**

*Fshini lotët dhe më tha Tomori:*

....

*O shqiptarët e gjorë  
Nëgjoni Baba – Tomorë  
Kombi juaj s'vetet mbarë  
Se besët u kanë ndarë  
Besa e bashkon njerinë  
Po ju pse e ndani perëndinë*

**16.** Cilën figurë stilistike përdor autori në këto vargje?

\_\_\_\_\_

1 pikë	
--------	--

**17.** Vendos S (saktë) ose P (pasaktë) pranë konstatimit që ka të bëjë me këto vargje.

1. Poezia nga e cila janë shkëputur këto vargje është patriotike
2. Kjo poezi titullohet sipas babait të poetit
3. Vargjet kanë rimë
4. Vargjet kanë ritëm të shpejtuar

<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>

1 pikë

**18.** Fjala e gjorë nga vargu i dytë në morfologji është:

---

1 pikë

**19.** A) Përshkruaji tri folje nga vargjet e dhëna.

---

1 pikë

B) Foljen nga vargu: Kombi juaj s'vetet mbarë, shkruaje në kohën e ardhme.

---

1 pikë



















**E PLOTËSON KOMISIONI PËR VLERËSIM**

Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara në test: \_\_\_\_\_

Nota: \_\_\_\_\_

**KOMISIONI:**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**VLERËSUESI KRYESOR:** \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_ 2016